



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 16.07.2013
Nr. 0204-922

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS,
01NR. 353-105896 të Pranuar me datë, 10.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 nr.353-105896 të miratuar me datën 28.06.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimit 01nr. 353-105896 për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 16.07.2013
Br. 0204-922

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik Opštine Pristina
Sami Hamiti, Predsedavjući Skupštine Opštine Pristina

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE PRIŠTINA,
01NR. 353-105896 Primljeno dana, 10.07.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim u članu 82 Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, dodatak XII Uredbe Vlade br.02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 01 nr.353-105896 usvojene dana 28.06.2013 od Skupštine Opštine Pristina, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu i Zakonu br.04/L-144 za Davanje na Korišćenje i Razmenu Nepokretne Opštinske Imovine.

Pravni akt, niže navaden ima puni pravni efekat .

- Odluka 01nr. 353-105896 za određivanje lokacije u cilju javnog interesa .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera & Ministar MALS

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe të nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25. 2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.06.2013, miratoi këtë

**VENDIM
PËR
CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR QËLLIM TË INTERESIT PUBLIK**

I.

MIRATOHET Vendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik: sipërfaqe gjelbëruese për nevojat e Komunës.

II.

Lokacioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, gjendet në Prishtinë, Zona kadastrale Prishtinë, parcela kadastrale nr. 5621 - 1, në sipërfaqe prej 166 m², shfrytëzues dhe pronar AKP - ja, NT "Voçar" me seli në Prishtinë, parcela kadastrale nr. 5621 - 2, në sipërfaqe prej 435 m², shfrytëzues dhe pronar Basri Rexhep Ismajli nga Prishtina, parcela kadastrale nr. 5622, në sipërfaqe prej 157 m², shfrytëzues dhe pronar Feim, Demir, Durgut, Atila dhe Vejbia Gjylderen të gjithë nga Prishtina, parcela kadastrale nr. 5623 - 1, në sipërfaqe prej 33 m², shfrytëzues dhe pronar Elvira Hasani nga Prishtina, pjesa e parcelës kadastrale nr. 5623 - 2, në sipërfaqe prej 78 m², shfrytëzues dhe pronar Amza, Sezair dhe Abdulj Hoxha nga Prishtina, pjesa e parcelës kadastrale nr. 5641 - 2, në sipërfaqe prej 7 m², shfrytëzues dhe pronar Basri Ismajl Rexhepi nga Prishtina, dhe pjesa e parcelës kadastrale nr. 5643, në sipërfaqe prej 67 m², shfrytëzues dhe pronar Aliriza dhe Sheqajdin Mejteni nga Prishtina.

III.

Kalimi i pronësisë nga personat fizikë dhe personat juridikë (AKP - ja), të cekur në pikën II të këtij vendimi, në emër të Komunës së Prishtinës, do të bëhet sipas dispozitave të Ligjit në fuqi për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

IV.

Lokacioni i cekur në pikën II të këtij vendimi, do të përfshihet në Planin rregullues urban të lagjes "Dodona" në Prishtinë, në pajtim me dispozitat e nenit 22 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor dhe dispozitat e nenit 14, të Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, të cilat zbatohen me qëllim të lëvizjeve të vogla në Planin rregullues urban të lagjes "Dodona" në Prishtinë.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Financave dhe Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 353-105896, më 02.07.2013

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, vcc. i dipl.



Arsyetim

Me qëllim të realizimit të Planit rregullues "Dodona", kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, që në procedurë të lëshimit të lejes së ndërtimit të merren parasysh edhe dispozitat që kanë të bëjnë me largësinë e ndërtimit të objektit me objektin e kultit - xhaminë, është propozuar që parcelat kadastrale të përfshira në pikën II të këtij Vendimi, të caktohen zonë me interes publik.

Lokacioni i cekur në pikën II të këtij j Vendimi, do të përfshihet në Planin rregullues urban të lagjes "Dodona" në Prishtinë, konform dispozitave të Ligjit për planifikim hapësinor dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për planifikimin hapësinor.

Kalimi i pronësisë nga pronarët fizikë dhe personat juridikë, do të bëhet konform dispozitave të Ligjit në fuqi për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të personave juridikë.

Propozimvendimi është shqyrtuar në Këshillin e Drejtorëve dhe pas shqyrtimit të tij në procedim të mëtejshëm, i dërgohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për miratim përfundimtar.